



Pranuar / Dorezuar Prilmen / Prodato Received / Delivery	05-10	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKIMFADK	6409/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1115/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1115/2023 të datës 25.08.2023 të parashtruar nga ankuesi _____, me adresë rruga _____

_____ ë Prishtinë, kundër masës disiplinore "Vërejtje me shkrim" me numër Ref, AUV 04/448/2023 të datës 28.07.2023 të shqiptuar nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Inspektoratit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të datës 05.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.1115/2023 e datës 25.08.2023 e parashtruar nga ankuesi _____

II. Anulohet masa disiplinore "Vërejtje me shkrim" me numër Ref, AUV 04/448/2023 e datës 28.07.2023 të shqiptuar nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Inspektoratit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, që brenda aftit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale dhe regjistri përkatës i nëpunësit civil, masën disiplinore të anuluar si në pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit Ibrahim Tërshnjaku i punësuar sipas Akt Emërimit me Nr. 367/1 të datës 31.01.2013 në pozitën *Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit Sanitar*, në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, Zëvendësuesi i Drejtorit të Inspektoratit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë më datë 28.07.2023 ka shqiptuar masën disiplinore *"vërejtje me shkrim"* numër Ref, AUV 04/448/2023, me arsyetimin se: *"Përkundër kërkesave të përsëritura nga ana e drejtorit të drejtorisë së inspektoratit që të raportoj me formën tabelore të inspektimeve të kryera nga sektori i inspektoratit sanitar ende vazhdon me mos plotësimin e tabelës së raportimit të Drejtorisë së Inspektoratit. Po ashtu përkundër kërkesave që të kërkoj raporte dhe plane të punës nga inspektorat sanitar dhe të ndërmarr masa ligjore nda inspektorëve sanitar, z. Tërshnjaku nuk ka ndërmarr veprime ligjore ndaj vartësve në këtë rast inspektorëve sanitar"*.

Ankuesi, kundër masës disiplinore *"Vërejtje me shkrim"* të datës 28.07.2023, përmes postës me datë 25.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5812/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë. Ndërsa Këshilli më datë 05.09.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5812/2023 të datës 25.08.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen me shkrim me numër Ref, AUV 04/448/2023 të datës 28.07.2023; Emaili i datës 05.04.2023 nga F.K për koordinatorët dhe shefat e sektorëve; Vendimin me Nr. 5422 të datës 03.08.2023; Raporti vjetor 2021 i Drejtorisë së Inspektoratit i datës 10.01.2022; Raporti gjashtë mujor 01.01-30.06.2023 nga zv. Drejtori i Inspektoratit; Vendim me Nr. Port: 05-3500 i datës 15.07.2022; Emailin e datës 22.05.2023 nga S.R për ankuesin; Emailin e datës 09.06.2023 nga ankuesi për S.R; Emailin e datës 09.06.2023 nga S.R për ankuesin dhe të tjerët; Emailin e datës 05.07.2023 nga ankuesi për S.R; Emailin datës 05.07.2023 nga P.H për ankuesin dhe të tjerët; Emailin e datës 16.06.2023 nga S.R për ankuesin dhe të tjerët; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.08.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 05.09.2023; Akt Emërimit me Nr. 367/1 të datës 31.01.2013; Përshkrimin e detyrave të punës për Udhëheqës të Sektorit të Inspeksionit Sanitar i datës 01.06.2011; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 26.01.2021; Emailin e datës 10.01.2023 nga A.A lidhur me dorëzimin e raporteve; Emailin e datës 31.08.2023 nga A.A për Q.A; Emaili i datës 27.06.2023 nga A.A për ankuesin; Emaili i datës 04.08.20213 nga ankues për B.D; Emaili i datës 16.06.2023 nga ankuesi për A.A; Raporti për periudhën 09-15.06.2023; Raporti për periudhën 18.07.2023 deri 24.08.2023; Raportin për periudhën nga data 28.07.2023

deri më datë 03.08.2023; Raporti për periudhën nga data 21.07.2023 deri më datës 28.07.2023; Raporti për periudhën nga data 14.07.2023 deri më datë 20.07.2023; Raportin për periudhën 07.07.2023 deri më datë 13.07.2023; Raportin për periudhën nga data 30.06.2023 deri më datë 06.07.2023; Raporti i periudhën nga data 30.06.2023 deri më datë 06.07.2023; Raportin për periudhën nga data 23.06.2023 deri më datë 29.06.2023; Raportin për periudhën nga data 16.06.2023 deri më datë 22.06.2023; Raportin për periudhën nga data 09.06.2023 deri më datë 15.06.2023; Raporti për periudhën nga data 09.06.2023 deri më datë 15.06.2023; Raporti për periudhën 02.06.2023 deri 08.06.2023; Vendimin e datës 06.10.2022; Vërejtjen me shkrim të datës 28.06.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës konstatoi se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore "Vërejtje me shkrim" të datës 28.07.2023, pretendon që kjo masë është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, ngase nuk është konstatuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike për faktin se i kam të kryera gjitha detyrat e parapara dhe at prej që jam i punësuar në këtë institucion.

Në kuptim të besueshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë (që ishte në fuqi në këtë periudhë të shqiptimit të masës disiplinore) lidhur me procedurën disiplinore të nëpunësve civilë, përkatësisht: nenit 45 i cili ka përcaktuar se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", nenit 46 ku parashihet se: "1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta...Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, prentimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjisllacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë", ndërsa Shkelje të lehta konsiderohen: "4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar", nenit 47 i cili

kishte paraparë se: " Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil", nenit 50, ku ishte paraparë se: "1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit. 5. Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore".

Referuar dispozitave të lartcekura si dhe gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit përmes të cilit ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore "Vërejtje me shkrim" e datës 28.07.2023, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të lëndës, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore nuk ka arritur të konstatoj drejtë gjendjen faktike, ngase nuk dihet për periudhën e raportimit dhe veprimeve të tjera e që janë mjaft relevante për këtë çështje ngase për të marr një veprim të tillë duhet merren për bazë dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Në këtë rast është dëshmuar me prova materiale që ankuesi në cilësi të Udhëheqësit të Sektorit të Inspektoratit Sanitar, në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, ka dërguar disa raporte javore si: Raportin për periudhën 09-15.06.2023; Raportin për periudhën 18.07.2023 deri 24.08.2023; Raportin për periudhën nga data 28.07.2023 deri më datë 03.08.2023; Raportin për periudhën nga data 21.07.2023 deri më datës 28.07.2023; Raportin për periudhën nga data 14.07.2023 deri më datë 20.07.2023; Raportin për periudhën 07.07.2023 deri më datë 13.07.2023; Raportin për periudhën nga data 30.06.2023 deri më datë 06.07.2023; Raportin për periudhën nga data 30.06.2023 deri më datë 06.07.2023; Raportin për periudhën nga data 23.06.2023 deri më datë 29.06.2023; Raportin për periudhën nga data 16.06.2023 deri më datë 22.06.2023; Raportin për periudhën nga data 09.06.2023 deri më datë 15.06.2023; Raportin për periudhën nga data 09.06.2023 deri më datë 15.06.2023; Raportin për periudhën 02.06.2023 deri 08.06.2023.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit dhe në vlerësim të të gjitha provave të lëndës, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, nuk ka argumentuar me prova konkrete ashtu si është përshkruar në aktin për shqiptimin e masës disiplinore të datës 28.07.2023, ngase nuk mund të argumentohet fakti se me veprimet e tija ankuesi ka bërë shkelje të nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse veprimet e ankuesit nuk korrespondojnë me barrën që i ngarkohet ankuesit sa i përket çështjes së shkeljes së dispozitës si në vijim: " kryerjen e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar," ngase për një gjë të tillë si u tha më lartë nuk ka prova relevante që argumentojnë shqiptimin e masës që është objekt i kësaj ankese.

Duke u bazuar në konstatimet si më lartë gjithnjë referuar pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar provat materiale të çështjes dhe si rrjedhojë ka konstatuar se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e vërtetimit të përgjegjësisë disiplinore të ankuesit nuk ka marrë parasysh të gjitha elementet për përcaktimin e drejtë dhe të plotë të përgjegjësisë së ankuesit si dhe parimet për individualizmin e masës disiplinore, sepse sipas aktit të

kundërshtuar me ankesë dhe shkresave të lëndës nuk është konfirmuar fakti se nga veprimi i ankuesit të jetë shkaktuar ndonjë pasojë apo dëm për institucionin, nuk është vërtetuar se ndaj ankuesit më parë ka pasur ndonjë vërejtje të shqiptuar e cila është në dosjen personale të tij (Vërejtja me shkrim e datës 28.06.2022 është shfuqizuar sipas Vendimit A.nr.653/2022 të Këshillit dhe sipas Vendimit të datës 06.10.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit Ekzekutiv të AUUV).

Ndërlidhur me të cekurat si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se masa disiplinore "Vërejtje me shkrim" numër Ref, AUUV 04/448/2023 e datës 28.07.2023 e shqiptuar nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Inspektoratit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë ndaj ankuesit është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që ishte në fuqi në këtë periudhë të cilat rregullojnë procedurën disiplinore të nëpunësve civil, gjegjësisht në kundërshtim me dispozitat e nenit 45 si dhe nenit 50 paragrafi 1 të njëjtit ligj, dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, kështu që e njëjta është e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht Udhëheqësi i Njëjesisë së Burimeve Njerëzore i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi, është i obliguar që bëjë heqjen e masës disiplinore ndaj ankuesit nga dosja personale e tij.

Bazuar në Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përkatësisht nenin 24 të këtij ligji ku parashihet: "Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin evendimit të Këshillit".

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1115/2023, datë 05/10/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Inspektoratit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

